

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me lëndë djegëse (dru dhe thëngjill) për nevojat e objekteve të Administratës komunale, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 28.5.2013, për lejimin e furnizim me lëndë djegëse (dru dhe thëngjill) për nevojat e objekteve të Administratës komunale për sezonin 2013/2014, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës i datës 28.5.2013, për lejimin e sigurimit fizik dhe mirëmbajtjen e objekteve të Komunës së Prizrenit, për periudhën gusht-dhjetor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për servisimin e klimatizimit në objektet e Komunës së Prizrenit (Administratës, Financave dhe në objektin e “Shtëpisë së Bardhë”), dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës i datës 28.5.2013, për lejimin e servisimit të klimatizimit në objektet e Komunës së Prizrenit (Administratës, Financave dhe në objektin e “Shtëpisë së Bardhë”), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës për lejimin e shpalljes së tenderit për servisimin dhe furnizimin me pjesë rezervë për autovetura të Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 28.5.2013, rreth lejit të servisimit dhe furnizimit me pjesë rezervë për autovetura të Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e kanalizimit dhe rrugëve lokale në fshatin Lubizhdë e Hasit dhe të kanalizimit në lagjen "Bajram Curri", dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 16.5.2013, për lejimin e ndërtimit të kanalizimeve dhe rrugëve lokale, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Kanalizimit dhe rrugëve lokale në fshatin Lubizhdë e Hasit, dhe
2. Kanalizimit në lagjen "Bajram Curri".

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për vendosjen e shenjzimit horizontal, vertikal dhe barrierave rrugore, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 28.5.2013, rreth lejimit të vendosjes së shenjzimit horizontal, vertikal dhe barrierave rrugore, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin me elemente betoni të rrugës “Enver Buqaj”, me participim, dhe mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 3.6.2013, rreth lejimit të ndërtimit me elemente betoni të rrugës “Enver Buqaj”, në lagjen “Jeta e Re”, me participim, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 4.6.2013 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kulturore Boshnjake, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

U shqyrtua propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 28.5.2013, për ndarjen (caktimin) e lokacionit për ndërtimin e Qendrës Kulturore Boshnjake ne Prizren, i cili gjendet në ngastrën kadastrore nr. 4793-0 dhe 293-0 në sipërfaqe prej përafërsisht 3 ari, në ZK Prizren.

Ky propozim i procedohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-6992

Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Greqi dhe pagesës së mëditjeve për Xhejlane Gjinin, zyrtare komunale, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 28.5.2013, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Xhejlane Gjinin, zyrtare komunale, për në Selanik të Republikës së Greqisë, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore që ka ta bëjë me trajtimin e vendbanimeve joformale në Selanik. Takimet do të mbahen nga data 29 maj deri me 31 maj 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurën,.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6994
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit rreth formimit të Komisionit teknik për organizimin dhe shënimin e manifestimeve të Qershorit, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013 mori këtë:

AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni teknik për organizimin dhe shënimin e manifestimeve të Qershorit: 10 Qershorit - Ditës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Prizrenit.

II. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

1. Kujtim Gashi, kryetar i komisionit,
2. Zeqir Xhaferi,
3. Urim Ukimeri,
4. Hamdi Bilurdagu, dhe
5. Visar Islamaj, anëtar

III. Detyrat e Komisionit teknik do të jenë: të përgatit projektin për organizimin e të gjitha aktiviteteve dhe pas përfundimit të të gjitha organizimeve, të mbledh dhe verifikoj të gjitha shpenzimet e bëra dhe të njëjtat ti procedoj për pagesë, si dhe mund të marrë veprime të tjera të nevojshme, të cilat janë në korniza të këtij manifestimi.

IV. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të emëruarit, si dhe Arkivi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së tij, Komisionit për Ankesa, në KK Prizren.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6996
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për manifestimin kulturor “Zgjimi me Art 2013”, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 28.6.2013, rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për manifestimin kulturor tradicional të komunitetit turk “Zgjimi me Art 2013”, i cili manifestim do të mbahet gjatë muajit qershor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 2000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës për lejimin e shpalljes së tenderit për lyerjen e objekteve shkollore, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 28.5.2013, rreth lejimit të lyerjes së objekteve shkollore në Komunën e Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6997
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Bullgari dhe pagesës së mëditjeve për Izet Osmanin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Izet Osmanit, zyrtar komunal, për në Republikën e Bullgarisë, me qëllim të pjesëmarrjes në seminarin që organizohet nga CNVP-ja me temën: "Decentralizimi i pyjeve". Seminari do të mbahen nga data 4 qershor deri me 6 qershor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin, për ditët e lartcekura.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6998
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për pranim-dorëzimin dhe regjistrimin e banesave si produkt i marrëveshjes në bazë të PPP-me ndërmarrjen "Global".

II. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

1. Raim Alija,
2. Dukagjin Berisha, dhe
3. Ylber Gashi.

III. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me marrëveshjen në bazë të PPP të lidhur me ndërmarrjen "Global", pikës I të këtij aktvendimi dhe në pajtim me ligjet në fuqi.

IV. Autorizohet drejtoresha e Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, znj. Fahrije Bytyqi, që në emër të Komunës së Prizrenit, të bëjë pranimin e çelësave të këtyre banesave.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen, Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të emëruarit, si dhe Arkivi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së tij, Komisionit për Ankesa, në KK Prizren.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-6999
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së - dega në Prizren, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në kërkesën e Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së - dega në Prizren, për furnizim me karburant, për nevojat e kësaj Shoqate, kështu që, i lejohet Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK, që të furnizohet me karburant, në vlerë deri në 1000 €, te operatori ekonomik i cili bënë furnizimin e Komunës me karburante.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Administratës- Sektori Teknik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Administratës-Sektori Teknik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, operatori ekonomik, ShFD, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-6757
Më 4.6.2013

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 4.6.2013, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me inventar për zyre për QPS-në, dhe mori këtë

KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 29.5.2013, rreth lejimit të furnizimit me inventar për zyre për nevojat e Qendrës për Punë Sociale, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-7000
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 108 të Ligjit për Procedurën Administrative, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 01-011-1477 të datës 29.1.2013, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë për Punës dhe Mirëqenies Sociale, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 01-011-1477 të datës 29.1.2013, që ka të bëjë me lejimin e mjeteve financiare për Shoqatën Bamirëse “Jetimët e Ballkanit” për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kuzhinës popullore, kështu që në vend të fjalës “në emër të pagesës vjetore të qirasë së lokalit (hapësirës) lejohen mjetet” duhet të jetë: “mjetet lejohen në emër të pagesës vjetore të gjërave ushqimore për nevojat e kuzhinës popullore”.

II. Pjesët e tjera të vendimit nr. 01-011-1477 të datës 29.1.2013, mbesin të pandryshuara.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-7001
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim për mbështetje financiare për mjekim të Qazime Elshanit (bashkëshortja e Islam Elshanit -shërbyes civil në Komunën e Prizrenit), kryetari i Komunës më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 2.5.2013, për lejimin e mjeteve për mbulimin e pjeshëm të shpenzimeve të mjekimit (operim) të Qazime Elshanit (bashkëshortja e Islam Elshanit -shërbyes civil në Komunën e Prizrenit), kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet në shumën prej 500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicionet e subvencioneve dhe mallrave dhe shërbime të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Islam Elshani, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-7002
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të mjekimit, Selajdin Veselin, shërbyes civil në Komunën e Prizrenit (arkëtar), kryetari i Komunës më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e pjesëshëm të shpenzimeve të mjekimit, për Selajdin Veselin, shërbyes civil në Komunën e Prizrenit (arkëtar), kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të mjekimit, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Selajdin Veseli, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-7003
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e udhëtimit zyrtar për në Shqipëri dhe mbulimin e shpenzimeve për Naile Paçarizin, zyrtare komunale, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e udhëtimit zyrtar të Naile Paçarizit, zyrtare komunale-juriste në shëndetësinë primare, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që ka të bëjë me menaxhimin e dokumenteve zyrtare, asetëve, logjistikës si dhe për udhëheqjen e procedurave disiplinore në administratën publike. Trajnimi do të mbahen nga data 30 maj deri me 2 qershor 2013, kështu që për këtë qëllim, është lejuar udhëtimi zyrtar dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve rreth trajnimit të lartcekur, lejohen mjetet financiare në shumën 499 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë për Shëndetësi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Shëndetësi dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Shëndetësi, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-7004

Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Shqipëri dhe mbulimin e shpenzimeve të Fitim Skerajt, mjek, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

VENDIM

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Fitim Skerajt, mjek në shëndetësinë primare, për në Tiranë të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punimet e Konferencës Internacionale për Shëndetin Publik. Konferenca do të mbahen nga data 6 maj deri me 7 maj 2013, kështu që për këtë qëllim, është lejuar udhëtimi zyrtar dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të rreth pjesëmarrjes në këtë konferencë, të lartcekurit i lejohen mjetet financiare në shumën 83.60 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë për Shëndetësi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësi dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësi, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-7006

Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mbulimin e shpenzimeve të Raim Bajramit, mjek, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Raim Bajramit, mjek në shëndetësinë primare, për në Çikago të Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me qëllim të pjesëmarrjes në punimet e Kongresit amerikan të Asociacionit të diabetëve. Kongresi do të mbahen nga data 19 qershor deri me 29 qershor 2013, kështu që për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të rreth pjesëmarrjes në këtë kongres, të lartcekurit i lejohen mjetet financiare në shumën 275 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë për Shëndetësi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësi dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësi, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-7007
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e udhëtimit zyrtar për në Turqi dhe mbulimin e shpenzimeve të Naim Fanajt, mjek, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejin e udhëtimit zyrtar të Naim Fanajt, mjek në shëndetësinë primare, për në Stamboll të Turqisë, me qëllim të pjesëmarrjes në punimet e Kongresit ndërkombëtar të Asociacionit psikiatrik botëror. Kongresi do të mbahen nga data 19 qershor deri me 23 qershor 2013, kështu që për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të rreth pjesëmarrjes në këtë kongres, të lartcekurit i lejohen mjetet financiare në shumën 150 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë për Shëndetësi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësi dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.


Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësi, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-7008
Më 4.6.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Belgjikë dhe pagesës së mëditjeve për Aliismet Çoçajn, drejtor i DBZhR, kryetari i Komunës, më 4 qershor 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Aliismet Çoçajn, drejtor i DBZhR, për në Bruksel të Belgjikës, me qëllim të pjesëmarrjes në seminarin që organizohet nga Komisioni Evropian lidhur me programin TAIEX në fushën e zhvillimit rural me zyrtar komunal. Seminari do të mbahen nga data 18 qershor deri me 22 qershor 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

